

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7948
E hënë, 9 dhjetor 2024
Çmimi 0.50

Rrëzohet Assadi nga pushteti, mediet thonë se u arratis në Moskë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

SIRIA E ASADIT RA ME IKJEN E ASADIT NGA DAMASKU. ÇFARË FURTUNE NJËJAVORE!

F. 5

Shkruan:
Muhamet
MAVRAJ



AKTUALE



TURQIA DISLOKON AFËR 350 TRUPA NË KOSOVË

F. 3

PDK-ja: DHOMAT E SPECIALIZUARA TË VEPROJNË ME PËRGJEGJËSI MAKSIMALE

F. 5

BANKA BOTËRORE E PËRKUSHTUAR PËR NDIHMË NË SANIMIN E DËMEVE NË IBËR-LEPENC

F. 7

EKONOMI



OPOZITA PRETENDON SE BUXHETI I VITIT 2025 ËSHTË ANTIKUSHTETUES, ÇKA NËSE DËRGOHET AI NË KUSHTETUESE?

F. 7

BQK-ja: TRI LIGJET E SEKTORIT FINANCIAR TË MIRATUARA NË KUVEND AVANCOJNË RRUGËN E KOSOVËS NË SEPA

F. 7

THAÇI: PRESIM FUNDIN E KËTIJ PROCESI, PRESIM DREJTËSI DHE RESPEKTIM TË KUSHTETUTËS SË KOSOVËS

FAQE 4-5



Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ish-udhëheqësi i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Bashkim Smakaj, nuk janë deklaruar të dielën rreth aktakuzës së ngritur ndaj tyre për ndikimin mbi dëshmitarët. Ndërkaq veterani i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Fadil Fazliu, është deklaruar i pafajshëm. Thaçi ishte ai që u paraqit i pari para Dhomave të Specializuara në Hagë. Gjatë seancës tha se ai nuk do të deklarohet, pasi nuk e ka lexuar aktakuzën në tërësi. "E di se Kosova është në prag të zgjedhjeve të përgjithshme, por unë nuk jam pjesë e garës elektorale dhe nuk paraqes rrezik për askënd. Prandaj, kërkoj edhe sot - unë respektoj dhe besoj në Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës - nga të gjithë, kudo që jeni ulur, në cilëndo anë apo në çdo uniformë që jeni në këtë sallë - të respektohet Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës", tha Thaçi

PDK-ja MBLODHI KËSHILLIN DREJTUES, KËRKOHET MOBILIZIM PËR FITORE NË ZGJEDHJET E 9 SHKURTIT

F. 3



SULM, FAJ, AKUZA: THIRRJE PËR HETIMET TË PAVARURA NË IBËR-LEPENC

F. 2

RENOVA
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Mavraj: Siria e Asadit ra me ikjen e Asadit nga Damasku. Çfarë furtune njëjavore!

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Publicisti Muhamet Mavraj ka reaguar pas rënies së regjimit të presidentit sirian, Bashar al-Assad.

Ai ka shkruar në "Facebook" se "Siria e Asadit ra me ikjen e Asadit nga Damasku. Çfarë furtune njëjavore!".

Mavraj ka theksuar se bashkë me Asadin ranë edhe të gjitha investimet ushtarake të Iranit, me të cilat sulmonte Izraelin dhe mbështeste Asadin.

Sipas tij, Rusia gjithashtu u mposht në Lindjen e Mesme. "Milionë refugjatë do të kthehen në atdhe", ka thënë ai.

Publicisti Mavraj ka thënë se në këtë drejtim Turqia është fituese e madhe në të dy frontet, ndërkaq Izraeli dhe ShBA-të me ata aleatë që ka andej e këndeje. "Kjo mundje dhe kjo fitore ndodhi në mandatin e ujkut të mençur, Biden. Askush si ai nuk



e njeh boshtin ruso-iranian", ka shkruar Mavraj, duke theksuar se radha është për rëniet përbrenda në vetë Iranin e Rusinë, herët a vonë. "Ata që nisin luftëra nuk përfundojnë pa dajak të fortë, por stupc fatal!", ka shkruar publicisti Mavraj.

POSTIMI I PLOTË I MAVRAJ:

Lajmi i fundit: Siria e Asadit ra me ikjen e Asadit nga Damasku. Çfarë furtune njëjavore!

Bashkë me Asadin ranë edhe të gjitha investimet ushtarake të Iranit me të cilat sulmonte Izraelin dhe mbështeste Asadin. Rusia gjithashtu u mposht në Lindjen e Mesme. Miliona refugjatë do të kthehen në atdhe. Mbështetja në ruset dhe Iranin është fatale. Edhe Armenia kështu humbi në Azerbajxhan, e la në baltë Rusia. Ajo është kaq e mbërthyer në lodhjen ukrainase. Turqia është fituese e madhe në të dy frontet (kjo e sundon Sirinë prej sot), Izraeli dhe ShBA-të me



ata aleatë që ka andej e këndeje. Kjo mundje dhe kjo fitore ndodhi në mandatin e ujkut të mençur, Biden. Askush si ai nuk e njeh boshtin ruso-iranian. Fatkeqësisht mbështetja trushpërlarë e Hamasit në atë bosht humbës shpërlau dhe rrafshoi për toke jo veç Gazën,

por ëndrrën palestineze. Kështu u shkërmoq edhe Hezbollahu e Libani. Radha është për rëniet përbrenda në vetë Iranin e Rusinë, herët a vonë. Ata që nisin luftëra nuk përfundojnë pa dajak të fortë, por stupc fatal!

Rrëzohet Assadi nga pushteti, mediet thonë se u arratis në Moskë

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Presidenti sirian Bashar al-Assad dhe familja e tij kanë arritur në Moskë, raportuan mediet shtetërore ruse, teksa rebelët kanë marrë kontrollin e kryeqytetit sirian, Damask, duke i dhënë fund sundimit brutal, gjysmëshekullor të familjes Assad.

Ministria e Jashtme e Rusisë tha më herët se Assadi "vendosi të jepte dorëheqje" pas "negociatave" me "një numër të pjesëmarrësve në konfliktin e armatosur" dhe u largua nga detyra "duke lënë instruksione për transferimin paqësor të pushtetit". "Rusia nuk mori pjesë në këto negociata", tha ministria. Kjo deklaratë erdhi pasi rebelët përmes një deklaratë të publikuar në televizionin shtetëror sirian thanë se Damasku "tani është i lirë nga Assadi", familja e të cilit ka sunduar për më shumë se 50 vjet.

Paraprakisht, Vëzhguesi sirian për të Drejtat e Njeriut - organizatë me bazë në Britani - kishte raportuar se Assadi ishte arratisur nga Damasku me një aeroplan mëngjesin e 8 dhjetorit. Ndërkaq presidenti i zgjedhur amerikan, Donald Trump, ka shkruar në llogarinë e vet në "Truth Social" se "Assadi është larguar nga shteti. Mbrojtësja e tij, Rusia, nuk ishte e interesuar ta mbronte më".

Kryeministri sirian Mohammad Ghazial-Jalali tha në një video se qeveria është "e gatshme të bashkëpunojë me çdo udhëheqje të zgjedhur nga populli". "Ne besojmë se Siria është vendi i të gjithë bijve të saj, dhe se ky vend mund të jetë një shtet normal që ndërton marrëdhënie të mira me fqinjët dhe botën pa u përfshirë në

ndonjë aleancë apo bllok rajonal", tha al-Jalali, duke shtuar se ai ishte ende në shtëpi në Damask dhe nuk kishte ikur. Më vonë, gjatë 8 dhjetorit, ai u pa duke dalë nga shtëpia e tij, i shoqëruar nga persona të armatosur. Ai raportohet se është shoqëruar për në takimin me udhëheqjen e grupit islamist, Hayat Tahriral-Sham (HTS), që ka udhëhequr ofensivën e fundit. HTS-ja konsiderohet grup terrorist nga Shtetet e Bashkuara, Britania, Kanadaja dhe Bashkimi Evropian.

Abu Mohammadal-Golani, udhëheqës i HTS-së, ka tentuar të sigurojë shiitë talavitë dhe minoritetet e tjera siciane, përfshirë të krishterët, pas rrëzimit të Assadit. Në Uashington, Shtëpia e Bardhë i tha Radios Evropa e Lirë se presidenti amerikan Joe Biden po "përcjell nga afër ngjarjet e jashtëzakonshme në Siri dhe është në kontakt të vazhdueshëm me partnerët rajonalë".

Lidhur me situatën në Siri, Bideni do të takohet më 8 dhjetor me këshilltarët e tij për sigurinë kombëtare. "Presidenti do të takohet me ekipin e tij të sigurisë kombëtare për të pranuar përditësime lidhur me situatën në Siri", shkroi në X, zëdhënësi i Këshillit të Sigurisë Kombëtare, Seam Savett.

Humbje për Rusinë

Ekspertët thanë se rënia e regjimit të Assadit do të paraqesë një humbje të madhe gjeopolitike për Kremlinin, i cili së bashku me Teheranin kanë mbështetur qeverinë siriane përgjatë luftës civile që nisi më 2011.

Instituti për Studim të Luftës, me bazë në ShBA, tha se "forcat e



regjimit të Assadit kanë kolapsuar dhe mbështetësit e Assadit duket se nuk kanë vullnet ta mbështesin ushtrinë arabe siriane, duke dislokuar menjëherë forca shtese".

Rusia ka disa ndërtesa ushtarake në Siri, përfshirë bazën ajrore në Hmeimim dhe një bazë strategjike detare në Tartus, baza që janë përdorur për t'i mbështetur veprimet e Kremlinit në Afrikë.

Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, nuk pranoi të komentonte për fatin e bazave ruse, duke thënë se "nuk është në interesin e askujt që të hamendësojmë".

Instituti për Studim të Luftës tha se Moskë ende nuk është evakuuar nga baza, "por mbetet e paqartë nëse Rusia do të mbajë anije në port, teksa rebelët sirianë vazhdojnë të avancojnë me shpejtësi në territoret e mbajtura nga regjimi".

Konstantin Kosachyov, zëvendëskryetar i Dhomës së Lartë të Parlamentit rus, tha më 8 tetor se të gjithë sirianët duhet të përballeshin vetë me luftën në shkallë të plotë, por sugjeroi se Moskë është e gatshme ta mbështesë popullin sirian në

rrethana të caktuara. Ruslan Suleymanov, ekspert rus për Lindjen e Mesme, i tha Radios Evropa e Lirë se Moskë do të "bashkëpunojë me rebelët" nëse ata e marrin pushtetin në Damask dhe se HTS-ja, po ashtu, "ka pretenduar më herët se është e gatshme të negociojë" me Kremlinin. "Putini dëshiron ta shpëtojë praninë e tij ushtarake në rajon. Në çdo rast, për ta bërë këtë, ai duhet të bëjë koncesione, si me xhihadistët ashtu edhe me [presidentin turk, Rexhep Tajip] Erdogan, i cili mbështet [rebelët]", tha ai.

Ofensiva e befasishme nisi më 27 nëntor nga një koalicion i grupeve të rebelëve. Ofensiva u udhëhoq nga HTS-ja. Përveç HTS-së, në ofensivë u përfshin edhe luftëtarë të grupit ombrellë të milicive siriane që mbështeten nga Turqia, të quajtur Ushtria Kombëtare Siriane. Turqia ka mohuar se ka mbështetur ofensivën, edhe pse ekspertët kanë thënë se kryengritësit nuk do të përfshiheshin në të pa pajtimin e këtij shteti.

Më 6 dhjetor, Kombet e Bashkuara thanë se pothuajse 300 000 persona në Siri janë

zhvendosur që nga fundi i nëntorit për shkak të luftimeve, duke shtuar se deri në 1.5 milion persona.

Assadi ishte varur nga Irani dhe Rusia për të qëndruar në pushtet që kur shpërtheu konflikti më 2011.

Qëkur rebelët morën kontrollin e Alepos një javë më parë, ata morën edhe qytete të tjera të mëdha, teksa forcat e Asadit bënë pak rezistencë.

Kush është HTS-ja?

Hayat Tahriral-Sham (HTS) është grup militant islamist, anëtarët e të cilit janë kryesisht salafistë, një sekt ultra-radikal i islamit sunit. Ky grup kërkon themelimin e një shteti në Siri që qeveriste sipas ligjit islamik.

Grupi u shfaq në skenë më 2012, një vit pas nisjes së luftës civile siriane. Fillimisht grupi u shfaq me emrin Jabhatal-Nusra, apo Fronti Nusra, degë siriane e Al-Kaidas.

I udhëhequr nga Mohammadal-Julani, grupi merri urdhra nga Abu Bakral-Baghdadi, udhëheqësi i Al-Kaidas në Irak. Baghdadi më pas shkëputi lidhjet me Al-Kaidan dhe themeloi grupin ekstremist, Shteti Islamik (IS), grup në të cilin Julani refuzoi të bëhej pjesë. Fronti Nusra u shndërrua në një nga grupet më vdekjeprurëse që luftojnë kundër Assadit dhe përdor taktika, sikurse bombardimet vetëvrasëse dhe pajisjet artizanale plasëse.

Grupi militant më pas ndryshoi emrin disa herë dhe u distancua nga Al-Kaida. Më 2017 ajo u bashkua me grupe të tjera opozitare në veriperëndim të Sirisë për ta formuar HTS-në.

Ky grup është i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe grupet aleate.

PDK-ja mblodhi Këshillin Drejtues, kërkohet mobilizim për fitore në zgjedhjet e 9 shkurtit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Partia Demokratike e Kosovës ka mbledhur të dielën Këshillin Drejtues, në të cilin është diskutuar për përgatitjen për zgjedhjet nacionale dhe zhvillimet e fundit politike në vend.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se zgjedhjet e përgjithshme më 9 shkurt janë një moment përcaktues për Kosovën dhe një mundësi për të zgjedhur një të ardhme më shpresëdhënëse. "Bedri Hamza është kryeministri më i mirë që mund ta ketë Kosova sot. Udhëheqja e tij do ta sjellë kompetencën dhe qartësinë për të cilën Kosova ka nevojë dëshpërimisht sot. Jam i frymëzuar nga mbështetja e madhe që kemi marrë nga qytetarët si brenda ashtu edhe jashtë vendit në mërgatën tonë gjatë këtyre muajve. Kjo mbështetje është një dëshmi e besimit që populli i Kosovës po

rikthen te partia jonë, programi ynë dhe vlerat tona", ka theksuar Krasniqi.

Ai u ka bërë thirrje të gjithë anëtarëve dhe mbështetësve të PDK-së të mobilizohen dhe të punojnë palodhur për fitore. "Partia Demokratike e Kosovës qëndron e bashkuar në misionin e saj për të ndërtuar një Kosovë më të zhvilluar, më të sigurt dhe më të mirë. Ne jemi një parti idesh dhe veprimi, vizioni dhe përkushtimi. Ne jemi partia që beson në fuqinë e njerëzve, forcën e demokracisë dhe premtimin e një të ardhmeje më të mirë. Ndërsa rritemi e zhvillohemi, le ta bëjmë këtë me guxim në zemrat tona dhe vendosmëri për veprimet tona, sepse ditët më të mira të vendit tonë janë para nesh", është shprehur lideri i PDK-së.

Kryetari Krasniqi ka ngritur shqetësimin lidhur me sfidat me të cilat është përballur Kosova si keqqeverisja, cenimi i sigurisë së shtetit, prishja e raporteve me partnerët strategjikë të vendit. "Mbi të gjitha, 2 muaj nga sot, ne

kemi zgjedhjet nacionale, të parat pas katër viteve të plota të një qeverie të paaftë. Prandaj, më shumë sesa një mbledhje rutinore, sot ne jemi në një takim vendimtar, i cili duhet të shërbejë si një shpallje e përkushtimit tonë të palëkundur për mobilizim dhe fitore. Sulmi terrorist i fundit ndaj infrastrukturës kritike të vendit tonë në Ibër-Lepenc ka tronditur shtetin tonë. PDK-ja kërkon një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi këtë akt kriminal dhe terrorist. Drejtësia duhet të vihet në vend shpejt, vendosmërisht dhe pa kompromis. I bëjmë thirrje edhe një herë bashkësisë ndërkombëtare që të qëndrojë pranë Kosovës dhe të reagojë me vendosmëri ndaj veprimeve të vazhdueshme armiqësore të Serbisë", ka thënë ai.

Ndërsa kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, i ka falënderuar të gjithë anëtarët për mobilizimin dhe organizimin në nivelin qendror dhe lokal për fitoren e PDK-së. "Janë muajt më

të rëndësishëm për ne si familje politike, për Kosovën si shtet, prandaj lëvizni çdo gur, siç i keni lëvizur për çdo fitore në të kaluarën. Punoni në qendrat tuaja dhe afroji njerëzit. Ashtu siç kemi vendosur të garojmë me sloganin 'Kosova mundet ma mirë', duhet ta dini që edhe PDK-ja mundet ma mirë! Të gjithë ne këtu mundemi ma mirë! Bashkë jemi më të fortë!", tha Hamza.

Ai është shprehur i lumtur se shumë qytetarë po e shohin PDK-në si alternativë për një Kosovë më të mirë si dhe shumë personalitete po i ribashkohen partisë. "Unë jam shumë i lumtur për rikthimin e shumë personaliteteve dhe aktivistëve përsëri në partinë tonë. Veçanërisht jam shumë i lumtur që para disa ditësh na u bashkua edhe Altini, djali i ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, z. Jakup Krasniqi. Tani jemi bashkë edhe ne, ashtu siç janë ata në Hagë. Më shumë se secili prej neve, presidenti Thaçi, kryetari Veseli, baci Jakup dhe të tjerët, duan që ne të jemi bashkë edhe në këtë

garë, që ta nxjerrim një rezultat sa më të mirë. Jo vetëm për vete, jo vetëm për partinë, por edhe për ata atje. Kur ne jemi më të fortë, edhe ata do të jenë më mirë. Në anën tjetër, jemi shumë të shqetësuar me sjelljen e Gjykatës Speciale, me abuzimet e prokurorisë së saj, siç edhe kemi reaguar këto ditë", tha kandidati i PDK-së për kryeministër.

Ndër të tjera, Hamza vuri në pah se sa më shumë që afrohen zgjedhjet parlamentare, aq më tepër do të shtohen tensionet në veri të Kosovës. "Në natën e sulmit terrorist në kanal in uhor të Ibër-Lepencit, siç e keni parë besoj edhe në mjetet e informimit, unë kam shkuar në vendngjarje menjëherë, në Varagë të Zubin Potokut që, në informimin tuaj, në atë fshat është vlarë edhe xhaxhai im. Jam munduar të jem në krye të detyrës si kandidat për kryeministër dhe si kryetar i Mitrovicës", tha ai.

Këshilli Drejtues i PDK-së miratoi Deklaratën Politike prej pesë pikave.

Turqia dislokon afër 350 trupa në Kosovë

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, njoftoi se ushtria e Turqisë ka dislokuar afër 350 trupa në këtë mision. "Ata do të zëvendësojnë njësitë italiane" në Forcat Operacionale Rezervë, tha KFOR-i.

Të 350 ushtarët, që janë nga brigada e 65-të e këmbëorisë, do të kryejnë një sërë aktiviteteve "së bashku me trupat e KFOR-it dhe do të

përfshihen në përgjigjen ndaj çdo zhvillimi të rëndësishëm të sigurisë".

KFOR-i përsëriti se është i aftë të parandalojë çdo rrezik të mundshëm përshkallëzues "dhe të përballet me çdo skenar të sigurisë" sipas mandatit që i buron nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

NATO-ja e ka shtuar praninë e saj në Kosovë gjatë vitit 2023 pas rritjes së tensioneve në veriu e

banuar me shumicë serbe. Aktualisht KFOR-i ka mbi 4 000 trupa ushtarake në Kosovë. KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës që është e para dhe pas misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit, EULEX.

Për sigurinë e kufijve të Kosovës me Serbinë është përgjegjës misioni i NATO-s, ndërsa për pjesën tjetër të vijës kufitare Policia e Kosovës.





Thaçi: Presim fundin e këtij procesi, presim drejtësi dhe respektim të Kushtetutës së Kosovës

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ish-udhëheqësi i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Bashkim Smakaj, nuk janë deklaruar të dielën rreth aktakuzës së ngritur ndaj tyre për ndikimin mbi dëshmitarët. Ndërkaq, veterani i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Fadil Fazliu, është deklaruar i pafajshëm. Thaçi ishte ai që u paraqiti i pari para Dhomave të Specializuara në Hagë. Gjatë seancës tha se ai nuk do të deklarohet, pasi nuk e ka lexuar aktakuzën në tërësi. “E di se Kosova është në prag të zgjedhjeve të përgjithshme, por unë nuk jam pjesë e garës elektorale, nuk paraqes rrezik për askënd. Prandaj, kërkoj edhe sot - unë respektoj dhe besoj në Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës - nga të gjithë, kudo që jeni ulur, në cilëndo anë apo në çdo uniformë që jeni në këtë sallë - të respektohet Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës”, tha Thaçi.

paraqes rrezik për askënd. Prandaj, kërkoj edhe sot - unë respektoj dhe besoj në Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës - nga të gjithë, kudo që jeni ulur, në cilëndo anë apo në çdo uniformë që jeni në këtë sallë - të respektohet Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës”, tha Thaçi.

Të akuzuarit pranë Dhomave të Specializuara kanë afat që brenda 30 ditësh të deklarohen rreth akuzave që ngrihen ndaj tyre. “Ende nuk i kam lexuar në tërësi, prandaj duhet t’i lexoj që t’i kuptoj”, tha Thaçi.

Pas deklarimit të Thaçit, gjykatësja kërkoi një pauzë të shkurtër, pasi avokatja e Thaçit kërkoi kohë që t’i japë udhëzime atij. Pas kësaj, Thaçi sqaroi se kur u pyet fillimisht nga gjyqtarja nëse i ka kuptuar akuzat ndaj tij, ai nuk e kishte kuptuar mirë pyetjen.

Gjykatësja kërkoi nga palët të vendosin një datë për vetëdeklarimin e Thaçit. Mbrojtja tha se është dakord që

më 7 janar 2025 Thaçi të vetëdeklarohet rreth aktakuzës. Gjykatësja Marjorie Masselot tha se më vonë do të lëshojë një vendim për këtë çështje.

Gjatë paraqitjes së parë, që zgjati pothuajse 45 minuta, Thaçi tha se ai, familja e tij dhe shoqëria e Kosovës presin përfundimin e procesit ndaj tij dhe tha se pret drejtësi.

Gjykatësja Marjorie Masselot vendosi që Thaçi të qëndronte në qendrën e paraburgimit - ku gjendet tash e katër vjet për shkak të rastit tjetër kundër tij - pavarësisht se avokatja mbrojtëse, Nina Tavakoli, tha se nuk ka rrezik që klienti i tij të arratiset.

Ndaj Thaçit, ish-ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçit, ish-shëfrit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Bashkim Smakaj, ish-kryetarit të Malishevës, Isni Kilajt, dhe Fadil Fazliut, më 29 nëntor është ngritur aktakuzë e re, e cila është bërë publike më 6 dhjetor. Në nisje të seancës, gjyqtarja e

**EPOKA
ERE**

MAL QORRAJ

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe ish-udhëheqësi i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Bashkim Smakaj, nuk janë deklaruar rreth aktakuzës së ngritur ndaj tyre për ndikimin mbi dëshmitarët. Ndërkaq, veterani i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Fadil

Fazliu, është deklaruar i pafajshëm.

Thaçi ishte ai që u paraqiti i pari para Dhomave të Specializuara në Hagë. Gjatë seancës tha se ai nuk do të deklarohet, pasi nuk e ka lexuar aktakuzën në tërësi.

Në paraqitjen e tij, Thaçi tha se “krejt papritmas para 2-3 ditësh” u njoftua për aktakuzën e re dhe nuk ka pasur kohë ta diskutojë në thelb këtë dokument me ekipin e tij

mbrojtës. “Me siguri e dini, unë që katër vjet përballem me një tjetër proces gjyqësor. E di që shoqëria kosovare, familja ime dhe unë presim fundin e këtij procesi, presim drejtësi. Krejt papritmas para 2-3 ditësh u njoftova për akuzën e re nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. E di se Kosova është në prag të zgjedhjeve të përgjithshme, por unë nuk jam pjesë e garës elektorale, nuk



procedurës paraprake, Marjorie Masselot, bëri përmbledhjen e rastit kundër pesë të akuzuarve dhe ai i lexoi të drejtat Thaçit. Ndërkaq, nga Zyra e Prokurorit të Specializuar u lexuan akuzat që rëndojnë ndaj Thaçit dhe katër të akuzuarve të tjerë. Ndërkaq, në paraqitjen e tij të parë para Dhomat të Specializuara, Bashkim Smakaj tha se dëshiron ta shfrytëzojë periudhën 30-ditore për t'u deklaruar për akuzat ndaj tij. Ai tha në gjykatore se pas konsultimit me avokatin mori këtë vendim, pasi që pret të marrë edhe materiale shtesë

për rastin kundër tij. Avokati i tij kërkoi lirimin nga paraburgimi dhe tha se Smakaj është i gatshëm të japë garanci 5 000 euro për lirimin me kusht dhe ta dorëzojë pasaportën e tij. Mbrojtja argumentoi se ai nuk paraqet rrezik që të arratiset. Prokuroria, ndërkaq, tha se nëse Smakaj do të lirohej me kusht ai do të mund të ndërhynte te dëshmitarët apo të kryente vepra të tjera penale. Gjyqtarja, pas një pauze të seancës, tha se argumentet e mbrojtjes nuk ishin të mjaftueshme për ta ndryshuar vlerësimin e saj sa i përket

qëndrimit në paraburgim të Smakajt. Ajo tha se ndaj Smakajt qëndron vendimi i saj për paraburgim prej dy muajsh. Seanca e tretë ishte paraqitja e Fadil Fazliut para Gjykatës në Hagë. Ai tha se para seancës është konsultuar me avokatin e tij dhe u deklarua i pafajshëm për akuzat ndaj tij. "Kam biseduar edhe me avokatin para një ore. Por, unë jam i pafajshëm, deklarohem i pafajshëm", tha ai. Edhe në rastin kundër Fazliut, gjykatësja nuk pranoi argumentet e mbrojtjes për lirimin e tij nga paraburgimi.

Çfarë thuhet në aktakuzën e re?

Në versionin e redaktuar të aktakuzës prej 15-faqesh, thuhet se Thaçi është takuar me katër të akuzuarit e tjerë në qendrën e paraburgimit në Hagë dhe aty pretendohet se ai u ka dhënë udhëzime se si të dëshmojnë dëshmitarët në rastin kundër tij.

Aktualisht në Hagë është duke u zhvilluar gjykimi ndaj Thaçit dhe ish-krerëve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, të cilët akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Më 5 dhjetor, Kilaj, Smakaj dhe Fazliu u arrestuan dhe një ditë më pas u dërguan në qendrën e paraburgimit në Hagë. Ndërkaq, ndaj Kuçit gjykata ka lëshuar fletëthirrje për t'u paraqitur para Dhomat të Specializuara të Kosovës, me seli në Hagë. Kuçi do ta bëjë paraqitjen e parë para gjykatës më 9 dhjetor. Po atë ditë paraqitjen e parë do ta bëjë edhe Isni Kilaj. Ai ishte paraparë të paraqitej të dielën, por mbrojtja e tij ka kërkuar që seanca të shtyhet për një ditë.

Thaçi akuzohet se bashkërendoi "tri grupe të veçanta" së bashku me Smakajn, Kilajn, Kuçin dhe Fazliun për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve të Prokurorisë në rastin kundër tij dhe të tjerëve për krime lufte. Aktakuza pretendon se veprat penale kundër administrimit të drejtësisë janë kryer nga 12 prilli 2023 deri më 2 nëntor po atij viti, gjatë vizitave jo të privileguara në objektin e paraburgimit në Hagë në mes të Thaçit dhe personave të tjerë të akuzuar.

Në aktakuzën e re, Thaçi ngarkohet me tri akuza për tentativa për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi; katër akuza për shkelje të fshehtësisë

së procedurës dhe katër akuza për mosbindje ndaj gjykatës. Fazliu, Smakaj dhe Kilaj akuzohen për tentativa për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, dhe për mosbindje ndaj gjykatës.

Kuçi përballat me dy akuza për mosbindje ndaj gjykatës.

Dhomat e Specializuara të Kosovës deri më tani kanë shpallur dy aktgjykime për pengim në administrim të drejtësisë.

Dy ish-figura të Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, janë dënuar për pengimin e drejtësisë deri tani.

Ndërkohë, Specialja ka shqiptuar edhe dy aktgjykime për krime lufte.

Gjykata Speciale u themelua në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës dhe është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por vepron me personel ndërkombëtar dhe ka selinë në Hagë.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar - që njihen edhe si Gjykata Speciale - hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000.

Droja nga frikësimi i dëshmitarëve ishte një prej arsyeve pse kjo gjykatë e Kosovës ndodhet në Hagë dhe jo në Prishtinë, "marrë parasysh se bëhet fjalë për çështje të ndjeshme dhe për faktin se disa nga të dyshuarit në pjesë të caktuara të shoqërisë kosovare mund të konsiderohen si luftëtarë të lirisë", thuhej në komunikatën e Qeverisë së Holandës, të lëshuar qysh në vitin 2016, kur ishte vendosur për këtë gjykatë.

PDK-ja: Dhomat e Specializuara të veprojnë me përgjegjësi maksimale

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, në mbledhjen e Këshillin Drejtues të dielën, ka ngritur shqetësimin për zhvillimet e fundit në Hagë, ku Zyra e Prokurorit Special ka njoftuar se ish-presidentit Hashim Thaçi i është shtuar edhe një aktakuzë për, kinse, pengim të drejtësisë, ndërsa ai

tashmë ka katër vite që ndodhet në paraburgim. "Lufta çlirimtare e popullit tonë ishte e drejtë, fisnike dhe e rrënjësor në të drejtën universale për liri dhe dinjtet. Çdo përpjekje për t'i dhënë tjetër kahe kësaj të vërtete, rrezikon ta minojë jo vetëm legjitimitetin e drejtësisë, por edhe ta cenojë trashëgiminë e një lufte të

shenjtë për liri. Ne apelojmë që Dhomat e Specializuara të veprojnë me përgjegjësi maksimale! Vendimet e tyre duhet të mbështeten vetëm në fakte dhe parime ligjore. Drejtësia nuk duhet, asnjëherë, të përdoret si mjet për ta rishkruar historinë apo për t'i kontestuar sakrificat e atyre që luftuan për lirinë e Kosovës", ka kërkuar ai.



Sulm, faj, akuza: Thirrje për hetime të pavarura në Ibër-Lepenc



PRISHTINË, 8 DHJETOR - Mes spekulimeve dhe akuzave të vazhdueshme, dyshimeve dhe tensioneve në rritje, përcaktimi i saktë i përgjegjësive për sulmin në kanalën e Ibër-Lepencit është kritik, sipas ekspertëve ligjorë dhe të sigurisë.

Përfshirja ndërkombëtare, sidomos e Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara, do ta rriste besueshmërinë e hetimeve, por do të ndihmonte edhe në uljen e tensioneve, thonë ata. Shpërthimi i 29 nëntorit në Ibër-Lepenc - kanalën në veri të Kosovës, prej nga furnizohen me ujë disa qytete dhe termoelektrana të vendit - u shkaktua nga rreth 20 kilogramë eksplozivë, sipas Policisë së Kosovës, dhe u cilësua si më i rëndi në infrastrukturën kritike të vendit që nga lufta e viteve 1998/99.

Sulmi shkaktoi dëme të konsiderueshme materiale dhe ndërprerje të furnizimit të rregullt me ujë dhe rrymë në disa zona.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e bëri përgjegjëse Serbinë për, siç u shpreh, "sulmin terrorist" dhe tha se ajo është duke i kopjuar metodat që aplikon Rusia në luftën e saj në Ukrainë. "Për ta bërë edhe më të dukshme këtë ndërlidhje, është edhe fakti se, gjatë kontrolleve të zhvilluara nga Policia e Kosovës në lokacione të ndryshme pas sulmit terrorist, përveç armëve dhe pajisjeve të shumta ushtarake, u gjetën dhjetëra emblema të njëjës ushtarake ruse", tha Kurti.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, mohoi se vendi i tij ka gisht në sulm dhe e dënoi atë. "Hetimet do të tregojnë se [kush e ka kryer], sepse edhe ne po i bëjmë hetimet tona. Kemi dyshime të caktuara, porse hetimet do të tregojnë se kush e

ka urdhëruar atë sulm", tha Vuçiq.

Në ditët pas sulmit, autoritetet e Kosovës kryen disa aksione në veri, gjatë të cilave konfiskuan armë, municione e pajisje të tjera ushtarake. Nga dhjetë të shoqëruar në polici si të dyshuar për përfshirje në sulm, dy u dërguan në paraburgim për një muaj.

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, tha më 2 dhjetor se është herët të dihet se kush është fajtor për sulmin dhe se në këtë fazë nuk mund të përjashtohet asnjë grup dhe asnjë shtet. "Shtetet e Bashkuara mbështesin një hetim gjithëpërfshirës. Ne u kemi ofruar autoriteteve të Kosovës mbështetje të plotë në këtë hetim. Mendojmë se është e rëndësishme që autorët të identifikohen dhe të mbahen përgjegjës", tha Hovenieri.

Njësoj edhe Bashkimi Evropian e dënoi sulmin dhe ofroi ndihmë në hetimin e tij.

Qeveria e Kosovës konfirmoi për programin Expose të Radios Evropa e Lirë se hetimin janë duke e bërë institucionet e vendit. Zëdhënësi Përparim Kryeziu tha se ato janë në komunikim të vazhdueshëm me partnerët ndërkombëtarë dhe se do të mund të ndihmohen edhe prej tyre.

Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, tha se gjatë një vizite në Bruksel këtë javë ka kërkuar bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar për hetimin e sulmit. Ajo, po ashtu, tha se u ka paraqitur zyrtarëve evropianë dëshmitë për "lidhjet e Serbisë" me sulmin, por nuk i ka specifikuar ato.

Gjatë një debati në Komisionin për Politikë të Jashtme të Parlamentit Evropian, disa deputetë shprehën solidaritet me Kosovën, por thanë se duhet

të shohin më shumë prova për përfshirjen e Serbisë. Disa si austriaku Thomas Waitz vunë në pah edhe nevojën për hetim ndërkombëtar.

Mark Ellis, drejtor ekzekutiv i Odës Ndërkombëtare të Avokatëve, me seli në Londër, thotë se mbështet idenë e një hetimi të tillë, në mënyrë që "situata të mos përshkallëzohet në diçka shumë më serioze".

"Unë nuk mendoj se kërkesa e Kosovës për ndonjë lloj përfshirjeje ndërkombëtare është shenjë dobësie. Kjo është një situatë, në të cilën autoritetet ndërkombëtare duan që tensionet të mbahen në minimum dhe të ketë një vlerësim shumë objektiv për atë që ka ndodhur. Sepse, tash për tash, Serbia thotë se nuk është e përfshirë, ndërsa autoritetet e Kosovës thonë që po. Ndjaj mënyra më e mirë për të dalë nga kjo rrugë pa krye është që të bëhet një vlerësim i pavarur, faktik dhe objektiv i asaj që ka ndodhur", thotë Ellis për Exposed.

Ellis thotë se Kosova ka disa partnerë ndërkombëtarë që mund të jenë të paanshëm dhe të ofrojnë ndihmë në hetimin e sulmit në Ibër-Lepenc - qofshin ato Shtetet e Bashkuara, misioni i BE-së për sundimin e ligjit, EULEX, apo misioni paqeruajtës i NATO-s, KFOR.

Kohëzgjatja e hetimeve thotë se nuk duhet të kufizohet, por të jetë aq sa është e nevojshme për të mbledhur prova dhe informacione të mjaftueshme. "Nuk mendoj se duhet një periudhë jashtëzakonisht e gjatë. Duhen vetëm përpjekje të përqendruara, me burimet dhe ekspertizat që posedojnë ShBA-ja dhe BE-ja", thotë Ellis.

Ish-zyrtari i NATO-s, Jamie Shea, thotë se me ngritjen e aktakuzës për sulmin në Banjskë, autoritetet e Kosovës

kanë treguar se mund të bëjnë hetime profesionale. Por, thekson se sulmi në Ibër-Lepenc është më i turbullt. "Padyshim që çdo ndihmë nga komuniteti i jashtëm është e dobishme. Bashkëpunimi nga Vuçiqi në Beograd do të mirëpritet po ashtu. Ai e mohon përfshirjen e Serbisë në këtë incident dhe, natyrisht, i hedh poshtë akuzat se ai është ideuar në Beograd. Tani për tani duhet besuar fjalëve të tij, por çdo ndihmë që ai mund të ofrojë do të ishte e dobishme", thotë Shea për Exposed.

Shea shpreh bindjen se incidentet e tilla kanë për qëllim ta prishin procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve. Ai thotë se ato shpesh ndodhin në kohën kur Bashkimi Evropian është duke përgatitur rundin e radhës të bisedimeve. Kështu, sipas tij, ishte edhe rasti i fundit.

Vetëm tri ditë pas sulmit në Ibër-Lepenc, Kurti dhe Vuçiqi ishin në Bruksel, ku zhvilluan takime të ndara me shefen e re të politikës së jashtme të BE-së, Kaja Kallas.

Ndonëse BE-ja tha se takimet nuk ishin pjesë e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, Shea thotë se pala e Kosovës duhet të ketë kujdes që udhëheqja e re evropiane të mos ftohet nga procesi si pasojë e refuzimit të saj për t'u takuar me palën serbe. "Unë shpresoj se do të mbizotërojnë kokat e mençura dhe do ta ndajnë dialogun nga ky incident, derisa hetimet vazhdojnë. Gjëja e fundit që dëshironi, është t'i lejoni sabotuesit t'i arrijnë lehtësisht qëllimet e tyre politike. Pra, atyre nuk duhet t'u jepet fitore e lehtë në këtë aspekt", thotë Shea.

Kurti dhe Vuçiqi u takuan për herë të fundit në shtator të vitit

të kaluar, kur biseduan për mënyrat e zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit për normalizimin e marrëdhënieve. Pak ditë pas atij takimi ndodhi sulmi në Banjskë, ku grupe të armatosura serbësh sulmuan Policinë e Kosovës dhe vranë një oficer.

Kurti pastaj e kushtëzoi pjesëmarrjen në takim me Vuçiqin me dorëzimin nga Serbia të Millan Radoičiqit, i cili e pranoi përgjegjësinë për organizimin e sulmit në Banjskë.

Gati një vit pas këtij sulmi, Prokuroria Speciale e Kosovës ngri aktakuzë kundër 45 personave të nacionalitetit serb, përfshirë Radoičiqin.

Prokurori i rastit, Naim Abazi, tha atëkohë se falë bashkëpunimit ndërkombëtar me ShBA-në, me shtete të BE-së dhe të tjera, prokuroria ka arritur të sigurojë "prova që ndihmuan në ngritjen e kësaj aktakuzë të fuqishme".

Ellis përmend si shembuj disa sulme nga lufta në Ukrainë dhe konfliktet në Lindjen e Mesme, ku hetimet ndërkombëtare janë treguar të dobishme. "... sepse ato kanë siguruar një vlerësim të paanshëm dhe objektiv të ngjarjeve që kanë ndodhur. Është e rëndësishme që ato ngjarje të mos përdoren për manovra politike nga palët e kundërta në konflikt", thotë Ellis.

Derisa punimet për riparimin e dëmeve në kanalën e Ibër-Lepencit vazhdojnë, banorët lokalë jetojnë me frikën se kur mund të ndodhë sulmi i radhës. Me gjithë përpjekjet e Radios Evropa e Lirë, ata nuk pranuan të flisnin para kamerës, por thanë se janë të shqetësuar për sigurinë e tyre. Mes kësaj rrëmuje, çdo mesazh i autoriteteve u duket si premtim i zbrazët.

BQK-ja: Tri ligjet e sektorit financiar të miratuara në Kuvend avancojnë rrugën e Kosovës në SEPA

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Me miratimin nga Kuvendi i Kosovës të tri ligjeve kyçe për zhvillimin e sektorit financiar të vendit: Ligjin për Bankat, Ligjin për Shërbimet e Pagesave dhe Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Terrorizmit, njëkohësisht është hapur rruga për hapat e radhës për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA).

Tri ligjet themelore të miratuara në harmoni me legjislacionin e Bashkimit Evropian përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt integritimit në tregun financiar të BE-së dhe avancimin e transparencës dhe gjithëpërfshirjes financiare, dhe do të kenë ndikim të rëndësishëm në ekonominë e vendit tonë, veçanërisht për lëvizjen e lirë të kapitalit me partnerin më të madh të Republikës së Kosovës,

Bashkimin Evropian, si dhe me vendet e rajonit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do ta procedojë miratimin e rregulloreve që dalin nga këto ligje dhe përditësojë paraaplikimin e bërë më 14 tetor në DG FISMA dhe në Këshillin Evropian të Pagesave (EPC) me informata plotësuese, përfshirë rregullativën e re të miratuar.

Miratimi i këtyre ligjeve dhe integrimi në SEPA pritet të sjellin përfitime të konsiderueshme ekonomike, por edhe të tjera, duke përfshirë një kursim vjetor të vlerësuar rreth 55 milionë euro nga tarifat për transferet ndërkombëtare, njëkohësisht duke rritur efikasitetin dhe shpejtësinë e transaksioneve, konkurrencën dhe gjithëpërfshirjen në tregun e pagesave, si dhe transparencën, mbrojtjen e konsumatorëve të shërbimeve financiare dhe integritetin e



sistemit financiar. BQK-ja shpreh mirënjohje për institucionet e Republikës së Kosovës, për mbështetjen në finalizimin e nismave të saj

ligjore, por edhe atyre evropiane, si Komisioni Evropian, në veçanti DG FISMA dhe DG NEAR, si dhe ekipeve të Bankës Botërore për kontributin

dhe mbështetjen gjatë procesit të përgatitjes së ligjeve dhe rregulloreve të nevojshme për plotësimin e kriterëve për anëtarësim në SEPA.

Opozita pretendon se buxheti i vitit 2025 është antikushtetues, çka nëse dërgohet ai në Kushtetuese?

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Opozita vazhdimisht ka proklamuar se buxheti i miratuar në Kuvendin e Kosovës për vitin 2025 është antikushtetues duke u lidhur në mënyrën e rritjes së pagave në sektorin publik.

Ani pse nuk ka ndonjë paralajmërim nga to, pasojat do të ishin të mëdha në ekonominë e vendit nëse dërgohet në Gjykatën Kushtetuese. Analistët politikë thonë se nëse opozita nuk vepron ashtu, atëherë kjo kauzë po përdoret vetëm për elektorat.

Në seancat plenare, në studio televizive, e me anë të postimeve në rrjetet sociale, vazhdimisht thanë që buxheti i vitit 2025 është antikushtetues. Mirëpo, partitë opozitare këtë deri tani e kanë lënë kryesisht të tillë, veç si deklarata.

Por, a kanë të drejtë ta dërgojnë të njëjtin në Gjykatën Kushtetuese pas miratimit në Kuvendin e Kosovës dhe çfarë ndodh? "Sipas nenit 113, jo më pak se 10 deputetë kanë të



drejtë t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar nëse është në përputhje me kushtetutën qoftë nga përmbajtja apo nga procedura, në raste të tilla normalisht kërkesa ka karakter suspensiv që domethënë se ndalon së

zbatuari derisa për të njëjtin të vendosë Gjykata Kushtetuese", ka theksuar Ardian Bajraktari, avokat.

Sipas tij, një vendim i tillë mund të merrte kohë deri në 6 muaj dhe kjo do të nënkuptonte humbje të mëdha ekonomike

për vendin. "Do të krijonte implikime të mëdha, dhe nuk do të mund të fillonte implementimi i buxhetit për vitin 2025, dhe si rezultat do të kalojmë në fazën tranzitore në të cilën do të bëhen vetëm pagesat mbi të ardhurat e

parapara në Ligjin e Buxhetit dhe ligjet e tjera në fuqi dhe nuk mund të fillojë asnjë projekt kapital i paraparë për periudhën e vitit 2025", ka theksuar Bashkim Mustafa, ekonomist.

Por, sipas analistëve politikë, opozita, nëse vetëm e quan të tillë dhe nuk ndërmerr ndonjë hap, atëherë gjithçka po e bën për fushatë dhe jo se e ka kauzë serioze. "Subjektet politike, nëse e kanë me të vërtetë seriozisht, do të duhej ta dërgonin në Gjykatën Kushtetuese dhe t'i vazhdojnë procedurat për vlefshmërinë ligjore të së njëjtës. Në qoftë se e njëjta nuk bëhet, atëherë subjektet politike opozitare po bëjnë vetëm fushatë", ka deklaruar Albinot Maloku, analist politik.

Argumenti i opozitës se buxheti është kundërkushtetues lidhet me rritjen e pagave pasi, sipas saj, kjo nuk mund të bëhet përmes buxhetit, por përmes rritjes së koeficienteve nga Ligji i Pagave.

Banka Botërore e përkushtuar për ndihmë në sanimin e dëmeve në Ibër-Lepenc

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Zëvendëskryeministri i Parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, gjatë qëndrimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është takuar me zëvendëspresidenten e Bankës Botërore për Evropën dhe

Azinë Qendrore, Antonella Bassani.

Gjatë këtij takimi u diskutuan një sërë temash të fushës ekonomike, fiskale dhe sektorale. Sipas njoftimit të Zyrës së Kryeministrit, Bassani shprehu keqardhje për sulmin ndaj Kosovës në kanalën e Ibër

Lepencit, duke theksuar se Banka Botërore është e përkushtuar për të ndihmuar në sanimin e dëmeve.

Zëvendëskryeministri Bislimi e falënderoi Bankën Botërore për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm dhënë Kosovës.



Rrëzimi i Bashar al-Assadit, një fund dramatik i një dinastie që sundoi për dekada me radhë



Presidenti sirian Bashar Assad u largua nga vendi të dielën, një fund dramatik i luftës së tij gati 14-vjeçare për të mbajtur pushtetin, ndërsa vendi i tij u dërrmua nga një luftë brutale civile që u kthye në një fushë beteje për fuqitë rajonale dhe ndërkombëtare.

Largimi i al-Assadit ishte në kontrast të plotë me muajt e tij të parë si president i fuqishëm i Sirisë në vitin 2000, kur shumë shpresonin se ai do të ishte një reformator pas tre dekadash të kontrollit të hekurt të babait të tij.

Vetëm 34 vjeç në atë kohë, okulisti i arsimuar në Perëndim ishte i apasionuar pas kompjuterëve dhe një njohës i mirë i teknologjisë, me një temperament të butë.

Por kur u përball me protesta kundër sundimit të tij që shpërthyen në mars 2011, Assad iu rikthye taktikave brutale të babait të tij në një përpjekje për të shtypur kundërshtarët. Ndërsa kryengritja u shndërrua në një luftë civile, ai nxori ushtrinë në qytetet e kontrolluara nga opozita, me mbështetjen e aleatëve të tij: Iranit dhe Rusisë.

Rrëzimi i Bashar al-Assadit, një fund dramatik i një dinastie

Grupet ndërkombëtare të drejtave të njeriut dhe prokurorët e akuzuan regjimin e al-Assadit për përdorim të gjerë të torturës dhe vrasjeve pa proces gjyqësor në qendrat e paraburgimit të drejtuara nga qeveria e Sirisë. Lufta ka shkaktuar vdekjen e gjysmë milioni njerëzve dhe ka zhvendosur gjysmën e popullsisë prej 23 milionësh të paraluftës të vendit.

Konflikti dukej se ishte ngrirë në vitet e fundit dhe qeveria e al-Assadit rifitoi kontrollin e pjesës më të madhe të territorit të Sirisë, ndërsa veriperëndimi mbeti nën kontrollin e grupeve opozitare dhe verilindja nën kontrollin kurd.

Ndonëse Damasku mbeti nën sanksione paralizuese perëndimore, vendet fqinje kishin filluar të pranonin realitetin e mbajtjes së vazhdueshme të pushtetit nga al-Assadi. Lidhja Arabe e pranoi përsëri si anëtare Sirinë vitin e kaluar dhe Arabia Saudite në maj njoftoi

emërimin e ambasadorit të saj të parë që nga ndërprerja e marrëdhënieve me Damaskun 12 vjet më parë.

Megjithatë, realiteti gjeopolitik ndryshoi me shpejtësi kur grupet opozitare në Sirinë veriperëndimore në fund të nëntorit ndërmorën një ofensivë të befashme. Forcat qeveritare kapitulluan me shpejtësi ndërsa aleatët e al-Assadit, të përfshirë në konflikte të tjera - lufta e Rusisë në Ukrainë dhe luftërat njëvjeçare midis Izraelit dhe grupeve militante të mbështetur nga Irani, Hezbollah dhe Hamas - nuk dukeshin të gatshëm të ndërhynin me forcë.

Fundi i sundimit të familjes Assad

Al-Assad erdhi në pushtet në vitin 2000 në një kthesë të fatit. Babai i tij kishte përgatitur vëllain më të madh të Basharit, Basilin, si pasardhësin e tij, por në vitin 1994, Basili u vra në një aksident automobilistik në Damask. Familja e solli Basharin nga Londra ku ai kishte një klinikë për sytë. Ai iu nënshtrua stërvitjes

ushtarake dhe mori gradën e kolonelit për të përmbushur kredencialet që një ditë të mund të merrte pushtetin. Kur Hafez al-Assad vdiq në vitin 2000, parlamenti uli me shpejtësi moshën minimale për presidentët nga 40 në 34. Ngritja e Basharit në postin e presidentit u çimentua nga një referendum kombëtar, në të cilin ai ishte i vetmi kandidat. Hafez, një ushtarak, sundoi vendin për gati 30 vjet gjatë të cilave krijoi një ekonomi të centralizuar të stilit sovjetik dhe përdori një grusht aq të hekurt ndaj kundërshtarëve sa sirianët kishin frikë edhe të bënë shaka për politikë me miqtë e tyre. Ai ndoqi një ideologji laike që kërkonte të eliminonte dallimet sektare, duke e vënë theksin tek nacionalizmi arab dhe imazhi i rezistencës heroike ndaj Izraelit. Ai formoi një aleancë me udhëheqjen klerikale shiite në Iran, konsolidoi dominimin sirian mbi Libanin dhe ngriti një rrjet grupesh militante palestineze dhe libaneze.

Bashari fillimisht dukej krejtësisht ndryshe nga babai i tij i ashpër. I gjatë dhe i dobët, ai kishte një natyrë të qetë dhe

të butë. Pozicioni i tij i vetëm zyrtar përpara se të bëhej president ishte si kreu i Shoqërisë Siriane të Kompjuterëve.

Gruaja e tij, Asma al-Akhras, me të cilën u martua disa muaj pas marrjes së detyrës, ishte tërheqëse, me stil dhe me origjinë britanike. Çifti i ri, i cili pati tre fëmijë, dukej se shmangte luksin e pushtetit. Ata jetonin në një apartament në lagjen e pasur Abu Rummaneh të Damaskut dhe jo në një pallat madhështor si udhëheqësit e tjerë arabë.

Fillimisht kur mori detyrën, al-Assad liroi të burgosurit politikë dhe lejoi lirinë e shprehjes. Gjatë "Pranverës së Damaskut", intelektualët e vendit mblidheshin për të diskutuar për artin, kulturën dhe politikën gjë, që ishte e pamundur nën kohën e babait të tij. Por pasi 1000 intelektualë nënshkruan një peticion publik duke bërë thirrje për demokraci pluraliste dhe liri më të mëdha në vitin 2001, dhe një grup u përpoq të formonte një parti politike, këto aktivitete u ndaluan nga policia e frikshme sekrete që burgosi dhjetëra aktivistë.

Përballë Pranverës Arabe, al-Assad u mbështet tek aleancat e vjetra për të mbajtur pushtetin

Në vend që të lejonte hapjen politike, al-Assad ndoqi rrugën e reformave ekonomike. Ai hoqi ngadalë kufizimet ekonomike, lejoi hapjen e bankave të huaja, u hapi dyert importeve dhe fuqizoi sektorin privat. Në Damask dhe qytete të tjera që ishin zhytur prej kohësh në mjerim, pati një bum qendrash tregtare, restorantesh të reja dhe mallrash konsumi. Turizmi u rrit. Në politikën e jashtme, ai vazhdoi linjën që kishte ndjekur i ati, bazuar në aleancën me Iranin dhe një politikë të ngulmimit për një kthim të plotë të Lartësive Golan të aneksuar nga Izraeli, megjithëse në praktikë al-Assad nuk u përball kurrë ushtarakisht me Izraelin.

Në vitin 2005, ai pësoi një disfatë të thellë me humbjen e kontrollit dhjetëvjeçar të Sirisë mbi Libanin fqinj pas vrasjes së ish-kryeministrit Rafik Hariri. Shumë libanezë akuzonin Damaskun se qëndronte pas vrasjes dhe Siria u detyrua të tërhiqte trupat e saj nga vendi ku një qeveri pro-amerikane erdhi në pushtet.

Në të njëjtën kohë, bota arabe u nda në dy kampe – njëri i përbërë nga vendet aleate të SHBA-së, të udhëhequra nga sunitët si Arabia Saudite dhe Egjipti, tjetri ku bënin pjesë Siria dhe Irani i udhëhequr nga shiitët me lidhje me Hezbollahun dhe militantët



palestinezë.

Gjatë gjithë kohës, al-Assad u mbështet përgjithësisht tek e njëjta bazë si babai i tij: sektori i tij alavit, një degë e Islamit shiit që përbën rreth 10% të popullsisë. Shumë nga postet në qeverinë e tij iu dhanë brezave të rinj të të njëjtave familje që kishin punuar për babain e tij. Po ashtu ai përfshiu anëtarët e klasës së re të mesme të krijuar nga reformat e tij, përfshirë familje të shquara tregtare sunite.

Al-Assad gjithashtu u mbështet tek familja e tij. Vëllai i tij më i vogël Maher drejtonte Gardën elitare Presidenciale dhe ishte në krye të goditjes kundër kryengritjes. Motra e tyre

Bushra ishte një zë i fortë në rrethin e tij të ngushtë, së bashku me bashkëshortin e saj, zëvendësministrin e Mbrojtjes Assef Shawkat, derisa ai u vra në një bombardim të vitit 2012. Kushëriri i Basharit, Rami Makhoul, u bë biznesmeni më i madh i vendit, duke drejtuar një perandori financiare përpara një mosmarrëveshjeje që çoi në largimin e Makhoulit.

Al-Assadi gjithashtu i kishte besuar gjithnjë e më shumë role kyçe gruas së tij, Asma, përpara se ajo të njoftonte në maj se po i nënshtrohej trajtimit për leuceminë dhe të largohej nga skena publike. Kur shpërthyen protestat në

Tunizi dhe Egjipt në vitin 2011, duke rrëzuar përfundimisht sundimtarët e tyre, al-Assadi mohoi se ekzistonte mundësia që e njëjta gjë të ndodhte në vendin e tij, duke këmbëngulur se regjimi i tij ishte në harmoni me popullin e tij.

Pasi Pranverës Arabe mbërriti në Siri, forcat e tij të sigurisë organizuan një goditje brutale, ndërsa al-Assad vazhdimisht mohoi se po përballlej me një revoltë popullore. Ai fajësoi "terroristët e mbështetur nga jashtë" se po përpiqeshin të destabilizonin regjimin e tij.


Retorika e tij u mirëprit në shumë nga grupet pakicë të Sirisë – përfshirë të krishterët, druzët dhe shiitët – si dhe disa

suni që i frikësoheshin perspektivës së sundimit nga ekstremistët sunitë edhe më shumë sesa sundimit autoritar të al-Assadit.

Ndërsa kryengritja u shndërrua në një luftë civile, miliona sirianë u larguan në Jordani, Turqi, Irak dhe Liban dhe në Evropë. Ishte ironike se si më 26 shkurt 2011, dy ditë pas rrëzimit nga pushteti të Hosni Mubarakut të Egjiptit nga protestuesit dhe vetëm disa ditë para se vala e protestave të Pranverës Arabe të përfshinte vendin e tij, al-Assad dërgoi një e-mail ku vinte në lojë refuzimin kokëfortë të udhëheqësit egjiptian për të dhënë dorëheqjen.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON Inver
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Të mërkurën tërhiqet shorti për 1/8 e finales së Kupës

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Të mërkurën, më 11 dhjetor nga ora 14:00, në ambientet e Federatës së Futbollit të Kosovës, do të bëhet tërheqja e shortit për fazën e 1/8 së finales së Kupës së Kosovës. Në

këtë fazë të garës janë kualifikuar 16 skuadra, prej tyre nëntë të Superligës dhe shtatë të Ligës së Parë, e të cilat do të synojnë të sigurojnë një vend në çerekfinale. Ekipe të pjesëmarrëse në këtë fazë

janë: Drita, Dukagjini, Drenica, Vushtrria, Llapi, Ferizaj, Vëllaznimi, Gjilani, Prishtina, Rilindja 1974, Prishtina e Re, Feronikeli 74, Suhareka, Malisheva, Dinamo dhe Trepça.

Shorti pritet të sjellë përballje interesante në këtë rreth. Befasinë më të madhe në fazën e kaluar e realizoi Rilindja 1974 që arriti ta eliminojë fituesin e kurorës së dyfishtë, Ballkanin.



Trepça fiton derbin ndaj Prishtinës, Prizreni mposhti Vëllaznimi

“Epoka e re”

PRISHTINË, 8 DHJETOR - Super derbi i javës së 11-të të ProCredit Superligës i ka takuar Trepçës, që triumfoi në kryeqytet ndaj Sigal Prishtinës me rezultat 68:81 (13:22, 20:19, 21:16, 14:24). Mysafirët e nisën ndeshjen më mirë, ku me një seri 0:13 nga 6:3 kaluan në epërsi 6:16, derisa e fituan çerekun e parë 13:22. Vendasit barazuan shifrat në 28:28 në periudhën e dytë, por “Xehetarët” sërish u shkëputën, për të shkuar në pushim me rezultat 33:41. Kryeqytetasit e nisën fuqishëm pjesën e dytë, për të barazuar rezultatin në 41:41, megjithatë, kampionët nuk lejuan përmbysjen, kurse shifrat pas 30 minutash ishin 54:57. Në dhjetë minutat e fundit dhe

vendimtar, Trepça tregoi forcën dhe u shkëput, për të triumfuar 68:81. Te bardhekaltrit u dalluan Qua Grant me 27 pikë e gjashtë kërcime dhe Daniel Lekndreaj me 15 pikë e tetë kërcime, ndërsa te mitrovicasit u dalluan Mikailë Tmusiq me 19 pikë, shtatë kërcime e katër asistime, Samuel Hunter me 16 pikë e katër kërcime dhe Desmond Cambridge me 17 pikë e shtatë kërcime. Sigal Prishtina ka gjashtë fitore e katër humbje, kurse Trepça është e para me nëntë fitore e dy humbje. Proton Cable Prizreni shënoi fitore shumë të rëndësishme ndaj Vëllaznimit me shifrat 80:70 (17:21, 19:16, 24:16, 20:17), në javën e 11-të të ProCredit Superligës. Në çerekun e parë mysafirët për një nuancë ishin më të mirë, 17:21, derisa e kundërta ndodhi në atë të dytë, 19:16,



për të shkuar në pushim me rezultat 36:37. Dallimi vendimtar u bë në periudhën e tretë, ku prizrenasit ishin shumë më të mirë, 24:16, derisa në dhjetë minutat e fundit, të dy skuadrat luftuan deri në fund për fitore, duke dhënë maksimumin, pasi ishte sfidë shumë e rëndësishme, derisa Proton Cable Prizreni arriti të triumfojë me dhjetë pikë dallim, 80:70. Më të mirët te vendasit ishin Lenzelle Smith me 25 pikë, dhjetë kërcime e tetë asistime dhe Darryl Jordan me 19 pikë e shtatë kërcime, kurse te mysafirët u dalluan Trey Anderson me 16 pikë e 12 kërcime dhe Michael Nuga me 15 pikë, pesë kërcime e gjashtë asistime. Proton Cable Prizreni ka tri fitore e tetë humbje, ndërsa Vëllaznimi katër fitore e shtatë humbje.

Orges Shehi e nis me barazim te Ballkani, Feronikeli 74 merr një pikë në Malishevë



FERIZAJ, 8 DHJETOR - Dy përballjet e se dielës në kuadër të javës së 16-të të Albi Mall Superligës së Kosovës në futboll përfunduan me barazime. Trajneri i ri i Ballkanit, Orges Shehi, e nisi aventurën e tij te suharekasit me një barazim 1-1 ndaj Ferizajt, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin me bar sintetik në Ferizaj. Ballkani e gjeti avantazhin në minutën e 24-t përmes golit të Walid Hamidit, por vendasit barazuan në minutën e 84-t

me anë të Abdeen Abdul. Ky është barazimi i katërt radhazi për Ballkanin, që ka grumbulluar 27 pikë dhe mban vendin e tretë, 10 pikë prapa lideres, Dritës, dhe dy pikë prapa Malishevës, që është në vendin e dytë. Ndërkaq, Ferizaj, me këtë pikë, ngjitet në vendin e tetë me 17 pikë, falë goldallimit më të mirë se Dukagjini, që ka po ashtu 17 pikë dhe mban pozitën e nëntë. Llapi, gjithashtu me 17 pikë, ndodhet në vendin e shtatë.

Në përballjen tjetër, që u zhvillua në stadiumin “Liman Gegaj”, Malisheva dhe Feronikeli 74 ndanë pikët në një barazim pa gola. Rezultati është një hap prapa për Malishevën në garën për kreun e tabelës, derisa Feronikeli 74, me këtë barazim, arrin në kuotën e 7 pikëve dhe dëshmon se nuk është dorëzuar për t’iu shmangur rënies nga elita. Java e 16-të përmbyllet të martën, kur Suhareka e pret Llapin.


Vushtrria mposhti Llapin

VUSHTRRI, 8 DHJETOR - Vushtrria e ka fituar ndeshjen më interesante të xhiros së 12-të të Superligës së Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Të dielën në palestrën “Jeton Tërstena – Tota”, Vushtrria mposhti Llapin

me rezultat bindës, 39:29. Erkan Abazxhiku ishte më efikas te vushtrriasit me dhjetë gola. Nëntë i realizoi Egzon Ademi e tetë i kishte Muhamet Hyseni. Nga shtatë gola për llapjanët i realizuan Blerton Hasani e Ardi Halili. Me katër gola

ndeshjen e përfundoi Enis Rexhepi. Me fitore Vushtrria doli në vendin e pestë me tetë pikë, sa i ka edhe Vjosa në vendin e gjashtë dhe Llapi në të shtatin. Po të dielën, Besa Famgas fitoi ndaj Vjosës në Shtime me rezultat

42:25. Jon Vokshi u shqua te pejanët me 12 gola. Tetë i kishte Olsi Mulaj. Festim Mustafa i kishte 12 gola për Vjosën, kurse Erblin Qerimi e Stefan Kocharov i realizuan nga katër. Besa Famgas është e dyta me 18 pikë.





SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Mbikëqyrës i Lartë Bankar
Grada e pozitës:	pesë (5)
Kohëzgjatja e punësimit:	pa afat
Departamenti:	Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare
Divizioni:	Divizioni i Mbikëqyrjes në Vend
Raporton tek:	Udhëheqësi i Divizionit për Mbikëqyrjen në Vend

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Kryen ekzaminimet në vend dhe shqyrton raportet e bankave;
- Udhëheqë ekipin e ekzaminierëve në ekzaminimet në vend në banka;
- Planifikon, koordinon dhe udhëheqë resurset dhe kohën e nevojshme për ekzaminimet në vend në banka;
- Përcakton fushëveprimin e ekzaminimeve në vend dhe identifikon masat detyruese pas ekzaminimit, ndaj bankave;
- Përpilon raportet e ekzaminimit dhe vlerëson përshtatshmërinë e draft raporteve të përgatitura nga ekzaminierët bankarë për fushat e tyre të përgjegjësisë, në ekzaminimet në vend në banka;
- Përgatitë strategjitë mbikëqyrëse konform profilit të rrezikut të bankave dhe i rekomandon mbikëqyrësit shpeshësinë dhe fushëveprimin e ekzaminimeve në vend;
- Identifikon rreziqet dhe veprimet detyruese si dhe rekomandon përshtatjen e strategjive mbikëqyrëse të bankave;
- Monitoron performancën financiare, zbatimin e rekomandimeve, kërkesat nga ekzaminimet në vend, si dhe zbatimin e masave detyruese të shqiptuara ndaj bankave;
- Sipas kërkesës së drejtorit të departamentit, merr pjesë në ekzaminime dhe kur kërkohet udhëheqë ekzaminimet në vend edhe për IMF – IFJB;
- Udhëzon dhe bartë njohuritë tek mbikëqyrësit bankar dhe mbikëqyrësit e ri bankar;
- Ndihmon në përpilimin e politikave, rregulloreve, udhëzimeve, si dhe procedurave të brendshme tjera të punës;
- Detyra tjera të caktuara nga mbikëqyrësi në kuadër të përgjegjësi të Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Të ketë të kryer fakultetin ekonomik, menaxhment, financa, kontabilitet, matematikë, informatikë;
- Të ketë minimum 3 vite përvojë pune profesionale në risk, financa, kontabilitet, auditim apo të ngjashme.
- Përvoja në banka apo sektorin financiar është e preferueshme.
- Preferohet të ketë diplomë/certifikatë ekuivalente i nivelit të kontabilitetit të certifikuar dhe/ose të auditorit të certifikuar.
- Njohuri të shquara analitike, të nevojshme për analiza financiare, si dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e menaxhimit të rreziqeve bankare në banka;
- Njohuri të shquara të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF), me qëllim të identifikimit dhe verifikimit të përshtatshmërisë së transaksioneve në regjistrimet kontabël të bankave;
- Njohuri të shquara për kuadrin ligjor, rregulloret dhe standardet aplikative të zbatueshme ndaj bankave për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre;
- Kërkohet përpikëri në respektimin e afateve për punët dhe angazhimet e caktuara nga mbikëqyrësi;
- Kërkohen aftësi të shquara për vlerësime dhe vendimmarrje të pavarur nga mbikëqyrësi;
- Kërkohet të demonstroj aftësi të shquara të komunikimit gojor, komunikimit me shkrim, të dëgjimit dhe prezantimit tek mbikëqyrësi, ekipi i ekzaminimit dhe palët tjera;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në ekip; aftësi në menaxhimin e kohës lidhur me kompletimin dhe cilësinë e detyrave të punës; aftësi për të punuar në mënyrë efektive me mbikëqyrësin dhe ekipin; aftësi të punuarit, diskutimit dhe bindjes me palët e jashtme;
- Njohja e mirë e Ms. Office.
- Preferohet të ketë njohje të gjuhës angleze.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **24 dhjetor 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



OGLAS O SLOBODNOM RADNOM MESTU

Naziv radnog mesta:	Viši bankarski supervizor
Stepen pozicije:	pet (5)
Trajanje radnog odnosa:	bez roka
Odeljenje:	Odeljenje za nadzor banaka
Odsek:	Odsek za nadzor u zemlji
Izveštava:	Rukovodiocu Odseka za nadzor u zemlji

Sažetak dužnosti i odgovornosti:

- Vrši preglede u zemlji i razmatra izveštaje banaka;
- Vodi tim ispitivača u ispitivanjima u zemlji u bankama;
- Planira, koordinira i vodi resurse i vreme potrebno za ispitivanja u zemlji u bankama;
- Utvrđuje obim ispitivanja u zemlji i utvrđuje obavezujuće mere nakon ispitivanja, protiv banaka;
- Sastavlja izveštaje o ispitivanju i procenjuje adekvatnost nacra izveštaja koje pripremaju ispitivači banaka za svoje oblasti odgovornosti u ispitivanjima u zemlji u bankama;
- Priprema strategije nadzora u skladu sa profilom rizičnosti banaka i preporučuje supervizoru učestalost i obim ispitivanja u zemlji;
- Identifikovanje rizika i obavezujućih radnji i preporučivanje prilagodavanja strategija nadzora banaka;
- Prati finansijske rezultate, sprovođenje preporuka, zahteva iz ispitivanja u zemlji, kao i sprovođenje obavezujućih mera nametnutih bankama;
- Na zahtev direktora odeljenja učestvuje na ispitima i po potrebi vodi ispitivanja u zemlji i za MMF – NFBI;
- Vodi i prenosi znanje supervizorima banaka i novim supervizorima banaka;
- Pomaže u izradi politika, propisa, smernica i drugih unutrašnjih procedura;
- Ostali poslovi koje dodeljuje supervizor u nadležnosti Odeljenja za nadzor banaka.

Potrebne kvalifikacije i iskustvo:

- Da ima završen fakultet za ekonomiju, menadžment, finansije, računovodstvo, matematiku, informatiku;
- Da ima najmanje 3 godine profesionalnog iskustva u rizicima, finansijama, računovodstvu, reviziji ili slično.
- Poželjno je iskustvo u bankarskom ili finansijskom sektoru.
- Poželjno je imati ekvivalentnu diplomu / sertifikat o nivou ovlašćenog računovođe i / ili revizora.
- Izvanredna analitička znanja neophodna za finansijsku analizu, kao i za procenu adekvatnosti upravljanja rizicima banaka u bankama;
- Izvanredno poznavanje Međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja (MSFI), sa ciljem identifikacije i verifikacije adekvatnosti transakcija u računovodstvenim evidencijama banaka;
- Izvanredno poznavanje zakonskog okvira, propisa i važećih standarda koji se primenjuju na banke radi procene njihove usklađenosti;
- Zahteva se tačnost u poštovanju rokova za radove i određena angažovanja od strane supervizora.
- Potrebne su izvanredne sposobnosti za nezavisne procene i donošenje odluka od strane supervizora;
- Potrebno je da pokaže izvanredne sposobnosti verbalne komunikacije, pisane komunikacije, slušanja i prezentacije supervizoru, ispitnom timu i drugim zainteresovanim stranama;
- Sposobnost efikasnog rada u timu; veštine upravljanja vremenom koje se odnose na završetak i kvalitet radnih zadataka; sposobnost efikasnog rada sa supervizorom i timom; sposobnost za rad, diskusiju i poslušnost spoljnim stranama;
- Dobro poznavanje MS Office.
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeće dokumente:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Motivaciono pismo u kojem se navodi interesovanje za ovu poziciju;
- Dokazi o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrda od poslodavca ili drugih relevantnih dokumenata koji služe za dokazivanje radnog mesta i radnog iskustva, ne dovodeći u pitanje relevantne akte za zaštitu ličnih podataka);
- Izveštaj Fonda za penzijske štednje Kosova (Trusti)** za odgovarajući period, ili poresko uverenje Poreske administracije (PAK) kada izveštaj Trusta nije zakonski primenjen;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti službeno priznate (nostrifikovane) od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za utvrđivanje državnosti Kosova.

Postupak apliciranja:

- Poslednji rok za apliciranje je **24. decembar 2024. godine**.
- Apliciranje se može obaviti online (<https://hris.bqk-kos.org>) putem službene internet stranice CBK-a. Ostali oblici apliciranja neće biti razmatrani.
- Obrazac aplikacije možete preuzeti preko službene internet stranice: www.bqk-kos.org



SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Mbikëqyrës i Lartë Bankar
Grada e pozitës:	pesë (5)
Kohëzgjatja e punësimit:	pa afat
Departamenti:	Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare
Divizioni:	Divizioni i Raportimit dhe Analizave
Raporton tek:	Udhëheqësit të Divizionit të Raportimit dhe Analizave

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Siguron që të dhënat të jenë të sakta, të qëndrueshme dhe të besueshme për marrjen e vendimeve;
- Përpunon dhe analizon të dhëna duke përdorur metoda dhe vegla të avancuara statistikore për të detektuar trendë dhe korrelacione për projeksionet e ardhme të departamentit të mbikëqyrjes bankare;
- Menaxhon dhe administron sistemet e brendshme të raportimit nga institucionet financiare për të gjeneruar raporte të sakta dhe në kohë që ndihmojnë menaxhmentin e BQK-së në vendimmarrje;
- Zhvillon modele dhe vizualizime duke përdorur mjete të ndryshme si Microsoft Power BI, Tableau, SQL etj, për të paraqitur informatat në një mënyrë të qartë dhe të saktë;
- Punon me akterët e brendshëm dhe të jashtëm për të kuptuar kërkesat për informata dhe nevojat e departamentit të Mbikëqyrjes Bankare për të ofruar rekomandime të mbështetura nga të dhënat;
- Monitoron dhe vlerëson cilësinë e të dhënave për të siguruar besueshmëri dhe integritet të të dhënave;
- Hulumton mjete, korniza dhe mekanizma për analizim të të dhënave, të cilat i propozon për përdorim brenda departamentit;
- Përgatit raporte periodike të cilat përpilohen nga të dhëna që vijnë në formate të ndryshme dhe platforma të llojllojshme;
- Shërben si zyrtar ndërlidhës me departamentin e teknologjisë informativë (TI-së) gjatë zhvillimit të sistemeve informatike të cilat kanë fokus departamentin e mbikëqyrjes bankare;
- Detyra tjera të caktuara nga mbikëqyrësi.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Të ketë të kryer fakultetin e matematikës, matematikës financiare, shkencave kompjuterike ose ekonomik;
- Të ketë përvojë pune prej së paku 3 vite në sistemet e menaxhimit të informacionit;
- Kërkohen aftësi të shquara analitike dhe intereptrim të të dhënave për të zgjidhur probleme specifike;
- Kërkohet të demonstroj aftësi të shquara të komunikimit verbal dhe me shkrim, dhe prezantimit tek mbikëqyrësi dhe palët tjera;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në ekip; aftësi në menaxhimin e kohës lidhur me kompletimin dhe cilësinë e detyrave të punës; aftësi për të punuar në mënyrë efektive me mbikëqyrësin dhe ekipin; aftësi të punuarit, diskutimit dhe bindjes me palët e jashtme;
- Njohuri të mirë lidhur me SQL server përfshirë SQL queries;
- Njohuri të mira të veglave për vizualizim të të dhënave);
- Njohja e mirë e Ms. Office;
- Aftësi të caktimit të prioriteteve të punës dhe të përbushjes së afateve;
- Preferohet të ketë njohje të gjuhës angleze.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- **Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **24 dhjetor 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



KONKURS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta:	Viši bankarski nadzornik
Nivo stepena:	Pet (5)
Trajanje radnog odnosa:	Na neodređeno vreme
Odeljenje:	Odeljenje za bankarski nadzor
Odsek:	Odsek za izveštavanje i analiza
Izveštava:	šefu Odeljenja za izveštavanje i analiza

Pregled dužnosti i odgovornosti:

- Stara se da podaci budu tačni, konzistentni i pouzdani za donošenje odluka;
- Obrađuje i analizira podatke koristeći napredne statističke metode i alate za otkrivanje trendova i korelacija za buduće projekcije Odeljenja za bankarski nadzor;
- Upravlja i administrira sisteme internog izveštavanja od finansijskih institucija da generiše tačne i blagovremene izveštaje koji pomažu upravi CBK-a u donošenju odluka;
- Priprema modele i vizuelizacije koristeći različite alate kao što su Microsoft Power BI, Tableau, SQL, itd., kako bi se informacije prikazale jasno i tačno;
- Radi sa internim i eksternim zainteresovanim stranama kako bi razumeo zahteve za informacijama i potrebe Odeljenja za bankarski nadzor kako bi pružio preporuke zasnovane na podacima;
- Prati i procenjuje kvalitet podataka kako bi se obezbedila pouzdanost i integritet podataka;
- Istražuje alate, okvire i mehanizme za analizu podataka, koje predlaže za upotrebu u okviru odeljenja;
- Priprema periodične izveštaje koji su sastavljeni od podataka koji dolaze u različitim formatima i različitim platformama;
- Služi kao službenik za vezu sa Odeljenjem za informacione tehnologije (IT) tokom razvoja informacionog sistema koji se fokusira na Odeljenje za bankarski nadzor;
- Ostale dužnosti koje odredi nadzornik.

Potrebne kvalifikacije i iskustvo:

- Ima završen fakultet matematike, finansijske matematike, računarskih nauka ili ekonomije;
- Ima radno iskustvo od najmanje 3 godine u sistemima za upravljanje informacijama;
- Potrebne su izvanredne analitičke veštine i tumačenje podataka za rešavanje specifičnih problema;
- Zahteva se da se pokaže odlične usmene i pismene veštine komunikacije i prezentacije kod nadzornika i drugih strana;
- Sposobnosti za efikasni rad u timu; veštine upravljanja vremenom u vezi sa izvršenjem i kvalitetom radnih zadataka; sposobnost efikasnog rada sa nadzornikom i timom; sposobnost rada, diskusije i ubeđivanja sa spoljnim stranama;
- Dobro poznavanje SQL servera uključujući SQL queries;
- Dobro poznavanje alata za vizuelizaciju podataka);
- Dobro poznavanje Microsoft Office;
- Sposobnost određivanja prioriteta u radu i pridržavanja rokova;
- Poželjno je poznavanje engleskog jezika.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za prijavu;
- Propratno pismo (motivaciono pismo) gde se ističe interesovanje za ovu poziciju;
- **Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje održane pozicije i radnog iskustva, bez kršenja relevantnih akata o zaštiti ličnih podataka);
- **Pregled iz Kosovskog penzionog štednog fonda (Trusta)** za relevantni period, ili poresku potvrdu Poreske administracije (ATK) kada pregled iz Fonda ne primenjuje se zakonski;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak prijave:

- Zadnji rok za prijavu je **24. decembar 2024. godine**.
- Prijava se može izvršiti preko interneta (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične internet stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali obrasci za prijavu neće se uzeti u obzir.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti preko zvanične internet stranice: www.bqk-kos.org



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me nenin 42 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2024 si dhe Vendimit të Auditorit të Përgjithshëm me Nr. 2124 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa
Numri i referencës:	ZLBF/ZKA/12-17/24
Grada:	ZKA-X6
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pranon dhe kontrollon të gjitha kërkesat e arritura për pagesë, sigurohet së janë në harmoni me Ligjin dhe rregulloret në fuqi;
- Siguron disponueshmërinë dhe alokimin e buxhetit në përputhje me procesin e fillimit të çdo aktiviteti dhe buxhetin e planifikuar;
- Mbikëqyr dhe vepron përmes sistemit informativ dhe procedurat për monitorimin e secilit proces të shpenzimeve buxhetore nga zotimi i mjeteve deri te ekzekutimi në Departamentin e Thesarit në MF;
- Bënë analizimin dhe kontrollimin e shpenzimeve si dhe regjistrimin e pagesave sipas kodeve dhe shumës në Sistemin Informativ të Financave të Kosovës (SIMFK)- Free Balance;
- Përmes raporteve të MFPT (SIMFK) përcjellë realizimin e pagesave dhe bënë barazimin e shpenzimeve në nivel ZKA-së;
- Përgatit dhe i raporton për planin dinamik të shpenzimeve për çdo javë, muaj, periudhe tremujorë e vjetor edhe mbanë kontakte të përhershme me zyrtarët përgjegjës për shpenzime të departamenteve përkatëse;
- Mban kontakte për punët dhe aktivitetet financiare dhe shpenzime me certifikuesin dhe zyrtarin kompetent të financave si dhe me udhëheqësit e programeve buxhetore;
- Menaxhon bazën e të dhënave për shpenzimet, kryen barazimet buxhetore dhe përgatitë raporte periodike dhe vjetore për shpenzime sipas kategorive dhe nën kategorive ekonomike dhe programeve ndaras për vitin aktual dhe raporton për gjendjen;
- Monitoron shpenzimet e buxhetit gjatë gjithë vitit brenda ZKA-së dhe rekomandon rialokimin e buxhetit kur është e nevojshme si dhe përgatitë raporte mbi shpenzimet buxhetore
- Kryen edhe detyra tjera profesionale në pajtim me legjislationin, të cilat mund të kërkohen nga mbikëqyrësi.

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

- Arsimimi: Diplomë fakulteti në ekonomi;
- Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në administratë, buxhet dhe financa.

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislationin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomati e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuar;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **24.12.2024 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U prilog članu 15.2 Zakona br. 05/L-055 za Generalnog Revizora i Nacionalnu Kancelariju Revizije Republike Kosovo, kao i članove 5, 6 i 7 Uredbe (NKR) 01/2024 o Prijemu i Karijeri u Nacionalnoj Kancelariji Revizije u vezi sa čl. 42 Uredbe (NKR) 02/2024 o Klasifikaciji Radnih Mesta; Godišnji Plan Zapošljavanja za 2024. godinu kao i Odluku Generalne Revizorke pod Br.2124 za ispunjavanje upražnjeno radnog mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS Za ispunjavanje slobodnog radnog mesta

1. Pozicija:	Viši Službenik za Budžet i Finansije
Referentni broj :	ZLBF/NKR/12-17/24
Rang:	NKR-X6
Broj pozicija:	Jedna (1)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Prima i kontroliše sve primljene zahteve za plaćanje, obezbeđuje da su u skladu sa Zakonom i važećim propisima ;
- Osigurava dostupnost i raspodelu budžeta u skladu sa procesom pokretanja svake aktivnosti i planiranim budžetom;
- Nadzire i posluje kroz informacioni sistem i procedure za praćenje svakog procesa budžetskih rashoda od angazovanja sredstava do izvršenja u Sektoru za trezor Ministarstva Finansija
- Analizira i kontroliše troškove kao i evidentiranje isplata prema šiframa i iznosima u Informacionom Sistemu Finansija Kosova (ISFK) – Free Balance;
- Kroz izveštaje MFPT (ISFK), pratiti realizaciju isplata i usaglašavanje troškova na nivou NKR;
- Priprema i izveštava o dinamičkom planu troškova za svaku sedmicu, mesec, tromesečje i godišnji period i održava stalne kontakte sa službenicima odgovornim za troškove nadležnih odeljenja;
- Održava kontakte za finansijske poslove i troškove sa overiocem i nadležnim finansijskim službenikom kao i sa rukovodiocima budžetskih programa;
- Upravlja bazom podataka za troškove, vrši usaglašavanje budžeta i priprema periodične i godišnje izveštaje za troškove po kategorijama i po ekonomskim kategorijama i posebne programe za tekuću godinu i izveštaje o stanju;
- Prati budžetske rashode tokom cele godine u okviru NKR-a i preporučuje preraspodelu budžeta kada je to potrebno, kao i priprema izveštaje o budžetskim rashodima
- Obavlja i druge stručne poslove u skladu sa zakonskom regulativom, koje može zahtevati nadzornik.

Opšti formalni uslovi za ovu radnu poziciju, su:

- Obrazovanje: Ekonomski fakultet ;
- Profesionalno iskustvo: Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u administraciji, budžetu i finansijama;

Opšti formalni uslovi za kandidate:

Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonom.

Postupak prijave:

Postupak prijave je otvoren za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i kandidatima iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati moraju dostaviti potrebnu dokumentaciju, i to:

- službeni obrazac NKR-a za prijavu;
- kopiju lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o školskoj spremi (Fakultetska diploma). Diplome stečene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Potvrda o Radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- potvrdu iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne stariju od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako se primenjuje);

U obzir će se uzeti samo zvanični obrazac za prijavu. Dokumenti dostavljeni nakon roka neće se razmatrati, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (online) i na internetskoj stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za predaju dokumentacije je dana **24.12.2024 u 16.00h**.

Obrazi za prijavu mogu se dobiti na recepciji NKR-a, ili se mogu preuzeti sa web stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org predati Odeljenju za administraciju dokumenata na adresi: Naselje Arberia, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00 časova, obrazac i prateća dokumentacija se mogu dostaviti i putem imejla na adresu rekrutimi@oagks.org ili putem pošte. Za detaljnije informacije možete nas kontaktirati na tel. 038/606-004, lokal 1025.

Napomena:

Prijave poslate poštom, koje nose poštanski pečat pošiljke poslate poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i biće razmatrane.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992





ROYAL CROWN;
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908
0.5L